ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr[1] i prokurimit	**205-24-4174-5-1-1**
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit me titull: : **"Trajtimi I vendeve te rrezikshme me qellim te ngritjes se nivelit te sigurisë rrugore(Eliminimi I Pikave te Zeza) ne rrjetin rrugor te Rrugëve Nacionale, Rajonale dhe Lidhëse"**

ANKESË

Emri i plotë i kompanisë:	**OE EL BAU Sh.p.k..**
Adresa:	Rr. Nato 99
Vendi:	Gjilan
Kodi postar:	60000
Numri Telefonit:	049 24 43 30
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj:	Fatlum Pireva
Adresa elektronike:	shpkelbau@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	03 korrik 2024
Nënshkrimi dhe vula:	

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

1. *Publikimi i Njoftimit për kontratë me datë 29.04.2024*
2. *Procedurë e hapur*
3. *Lloji i kontratës – Kontratë Publike Kornizë - Punë*
4. *Vlera e parashikuar 1,500,000.00 euro*
5. *Kriteri për dhënien e kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më te ulët*
6. *Afati i fundit per dorezimin e tenderit me dt. 13.05.2024, ora 14:00;*
7. *Njoftim mbi Vendimin e AK-se i dt. 10.06.2024*
8. *Kërkesa për Rishqyrtim, dt. 18.06.2024* ***(afati i fundit ditë vikendi e shtunë, e hëna festë zyrtare – Bajrami i Vogël)***
9. *Vendimi i AK-es i pranuar me datë 24.06.2024, me anë të cilit kërkesa për rishqyrtim e OE ankues është refuzuar si e pabazuar*
10. *Ankesa në OSHP parashtruar me datë 03 korrik 2024*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Procesi i hapjes është zhvilluar përmes platformës e-prokurimi pa praninë e përfaqësuesve të OE pjesëmarrës

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Me datën 18.06.2024, OE "El-Bau" Sh.p.k. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të AK-së për dhënien e kontratës, rrjedhimisht Letrës Standarde për Tenderuesin e Pasuksesshëm lidhur me OE ankues, duke paraqitur dhe argumentuar një mori shkeljesh ligjore që kanë ndodhur nga ana e akteve dhe veprimeve të AK-së në kundërshtim me kërkesat e DT, respektivisht dispozitat përktëse ligjore të LPP-së dhe RRPP, të cilat janë specifikuar në secilin pretendim të kërkesës për rishqyrtim. Kurse me datën 24.06.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuyuar kërkesën si të pabazuar.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Duke u bazuar në faktet dhe provat që i kemi gjetur gjatë qasjes dhe analizimit në dokumentacionin e dosjes/ofertës së dorëzuar nga GOE i shpërblyer, rezulton se tenderi/oferta e GOE fitues është e papërgjegjshme për shkak se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat (administrative, kualifikuese) te parashtruara në dosjen e tenderit. Po ashtu oferta e tij në shumicën e pozicioneve kyqe përmban çmime jo-normalisht të ulët të cilat sanksionohen me legjislacionin e e prokurimit në fuqi. Nga ana tjetër, tenderi i paraqitur nga OE ankues i ka plotësuar të gjitha kriteret e kualifikimit si dhe kriterin kryesor të dhënies duke u renditur pas ofertës së papargjegjshme të GOE të rekomanduar me kontratë. Por një situatë e tillë të cilën e kemi argumentuar me fakte dhe prova konkrete është injoruar nfga ana e AK-së gjatë zbatimit të procesit paraprak për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke mos i korrigjuar aktet dhe veprimet e kundërligjshme që ndërlidhen me vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve, respektivisht marrjen e vendimit të lartcekur.
Prandaj në këtë kontekst të gjendjes faktike rezulton se nga ana e AK-së, Komuna e Prishtinës, vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i tenderëve në është bërë në kundërshtim me parimet e prokurimit publik dhe në kundërshtim me dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik verzioni i konsoliduar (tutje referoju si LPP) si ligj material dhe legjislacionit sekondar Rregullorës për Prokurim Publik Nr.001/2022 (tutje referoju si RRPP), ashtu si në dispozitat më poshtë:

- Neni 1 në paragrafin 1 dhe 2 i LPP-së lidhur me nenin 4.3 i RRPP;
- Nenin 7 në paragrafin 1, 2 dhe 6 pika vi) i LPP lidhur me nenin 4.3 (c) i RRPP Nr. 001/2022
- Neni 56 paragrafi 1.1 dhe 1.2 i LPP-së;

- Neni 59 në paragrafin 4 i LPP-së i lidhur me nenin 40 paragrafi 1, 2, 6, 7 dhe 13 të RRPP Nr. 001/2022; nenin 8.5 (ii) dhe (iii) të UPP Nr. 001/2023
- Neni 60 në paragrafin 1.1 i LPP-së
- Neni 61 të LPP-së lidhur me nenin 41 paragrafi 3,4,5,6 si dhe neni 17.32 i RRPP Nr. 001/2022.
- Neni 65 në paragrafin 4.3 dhe 4.8 të LPP-së;
- Neni 69 në paragrafin 1 lidhur me paragrafin 4 nënparagrafin 1,2,4,5 të LPP
- Neni 108/A në paragrafin 12 të LPP-së
- Neni 48 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administative.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. Rrethanat e procesit të aktivitetit në fjalë.

1. Me datën 29.04.2024, parashtruesi i kërkesës për rishqyrtim OE "EL-BAU" Sh.p.k. ka paraqitur tenderin dhe ofertën lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull *"Trajtimi I vendeve te rrezikshme me qellim te ngritjes se nivelit te sigurisë rrugore(Eliminimi I Pikave te Zeza) ne rrjetin rrugor te Rrugëve Nacionale, Rajonale dhe Lidhëse"*, me numër të prokurimit 205-24-4174-5-1-1, të inicuar nga MMPHI. Ashtu që në relacion me GOE të shpërblyer me kontratë dhe ofertuesit tjerë i kanë plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret administrative, kualifikuese, dhe kriterin vlerësues ashtu siç janë specifikuar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë, dhe njëkohësisht siç përcaktohen në paragrafin 4 të nenit 59 lidhur me paragrafin 6 të nenit 40 të LPP-së dhe paragrafin 1.1 të nenit 60 të LPP-së si ligj material i zbatueshëm.

2. Por, pavarësisht kësaj situate, AK-ja, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e dispozitave ligjore përkatëse të zbatueshme në rastin konkret, nenit 59.4 të LPP-së lidhur me nenin 40 paragrafi, 1,2, 6,7 dhe 13 të LPP-së, nenit 60 paragrafi 1.1 dhe rrethanat e nenit 61 të LPP-së, e ka shpërblyer me kontratë GOE "TSR SH.P.K. & IDK SH.P.K.", përkundër faktit se AK, respektivisht komisioni i vlerësimit e ka pasur të qartë/ose e kundërta se tenderi/oferta e GOE në fjalë nuk i ka plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret në përputhje me përcaktimet në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit. Kurse nga ana tjetër në mënyrë të kundërligjshme dhe diskriminuese diskualifikohet tenderi/oferta jonë e cila është paraqitur në përputhje me të gjitha kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet ligjore që kontrata do t'i jepet OE ankues "EL-BAU" Sh.p.k. e cila sipas çmimit është renditur

pas ofertës së papargjegjshme të GOE. Kështu që, me datën 10.06.2024, AK-ja nxjerr dhe publikon në platformën e-prokurimi Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien e kontratës grupit të Operatorëve Ekonomik "TSR SH.P.K. & IDK SH.P.K." me çmimin për njësi 4,324.51€, dhe njëkohësisht Letrën Standarde për Tenderuesin e Pasuksesshëm për OE ankues "EL-BAU SHPK, përfshirë edhe letrat standarde për tenderuesit tjerë pjesëmarrës.

3. Parashtruesi i kërkesës për rishqyrtim OE EL-BAU SH.P.K., me datën 14.06.2024 përkundër vonesave të pajustifikueshme për tri ditë radhazi në kundërshtim me nenin 10.3 të LPP-së, pas insistimit të vazhdueshëm ka arritur që të sigurojë qasjen e kërkuar dhe aprovuar (me dt. 11.06.2024) në formë elektronike në dosjen/ofertën GOE fitues "TSR SH.P.K. & IDK SH.P.K.". Kështu që, duke u bazuar në qasjen dhe analizimin e dokumentacionit të dosjes/ofertës së dorëzuar nga GOE i shpërblyer, kemi gjetur/identifikuar se tenderi/oferta e GOE fitues është e papërgjegjshme për shkak se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe atë si vijon: kërkesat admninistrative lidhur me nenin 11.1 (krijimi i GOE) të FTD-së, kriteret e kualifikimit lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional për kërkesën nr. 3 (ing i gjeodezisë), për kërkesën nr. 4 (ing e komunikacionit), për kërkesën 7 lidhur me pajisjen e kërkuar në pikën 2 të Anëksit 3, për kërkesën nr. 8 (plani i menaxhimit të trafikut nuk është nënshkruar nga ing i komunikacionit). Po ashtu pas analizimit të hollësishëm që i kemi bërë ofertës financiare të GOE të lartëcekur që është shpërblyer me kontratë, kemi gjetur se i njejti ka ofertuar me çmime manipulative, nga njëra anë në disa pozicione me çmime jo-normalisht të ulëta nëse këto çmime krahasohen në relacion me çmimet reale të tregut që dëmtojnë konkurencën e ndershme në relacion me OE që paraqesin oferta të bazuara në çmime reale të tregut dhe që ndikojnë negativisht në në cilësinë e punëve dhe shërbimeve që janë objekt i kontratës. Kurse nga ana tjetër në disa pozicione ka ofertuar me çmime të fryera që janë shumë më të larta se ato të tregut që e dëmtojnë konkurencën e ndershme dhe ndikojnë në shpenzimin e fondeve publike në kundërshtim me qëllimin e nenit 1 dh 6 të LPP-së. Me fjalë tjera, kjo praktikë krijon një precedent të rrezikshëm që qon në degradim të të përgjithshëm të standardeve të ofertimit, dëmton konkurencën e ndershme të OE që paraqesin oferta të bazuara në çmime reale të tregut, rrezikon cilësonë e punëve dhe shërbimeve dhe shton koston e shpenzimeve të fondeve publike në kundërshtim me nenin 1 dhe 6 të LPP-së.

4. Lidhur me këtë kërkesë për rishqyrtim, AK-ja Komuna me datën 24.06.2024 ka marr vendim përmes të cilit ka vendosur që kërkesën e OE ankues El-Bau Sh.p.k. ta refuzojë si të pabazuar me një arsyetim të përgjithësuar të cilit i mungon analiza e argumenteve për kundërshtimin e kërkesës, rrjedhimisht nuk është i bazuar në asnjë fakt të provuar dhe në asnjë dispozitë ligjore të LPP-së si ligj material i zbatueshëm dhe RRPP. Nga arsyetimi i përgjithësuar i këtij vendimi shihet qartë se nga ana e AK-së nuk janë marrë parasysh argumentet dhe provat e paraqitura në

secilin pretendim ankimor të kërkesës për rishqyrtim, por të gjitha këto fakte dhe prova relevante janë injoruar dhe anashkaluar në tërësi, gjë të cilat lehëstisht kanë mundur të vërtetohen nga dokumentacionit i dosjes/ofertës së dorëzuar nga GOE i shpërblyer me kontratë. Në këtë mënyrë, ky vendim i kundërligjshëm nuk e pasqyron zgjidhjen e drejtë, të barabartë dhe të ligjshme të lëndës në relacion me gjendjen e saktë faktiko-juridike, rrjedhimisht me kërkesat e dosjes së tenderit dhe bazës ligjore të zbatueshme, LPP dhe RRPP (përshkrimin e plotë shih në vijim të këtij pretendimi ankimor)

5. Prandaj, duke qenë se nga ana e AK-së edhe gjatë procesit paraprak për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, nuk janë ndërmarrë veprime që kanë për qëllim korrigjimin e akteve dhe veprimeve të kundërligjshme që ndërlidhen me vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve dhe marrjen e njoftim mbi vendimin e AK-së, dhe njëkohësisht duke qenë se ky vendim ka cenuar të drejtat dhe interesat tona ligjore në raport me interesin material nga kjo kontratë, OE ankues detyrohet t'i drejtohet OSHP-së me këtë ankesë të bazuar/mbështetur në fakte dhe prova të argumentuara për secilën shkelje të pretenduar, në mënyrë që të njejtat të vlerësohen dhe shqyrtohen nga eksperti shqyrtues/paneli shqyrtues në mënyrë profesionale dhe meritore si dhe në pajtueshmëri me këtë ligj.

2. Përshkrimi faktik dhe ligjor i pretendimeve ankimore

Pretendimi ankimor kundër aktendimit i datës 24.06.2024 për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE ankues "El-Bau" si të pabazuar.

Nga ana e Divizionit të Prokurimit të MMPHI, përmes vendimit të datës 24.06.2024 është refuzuar si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga OE El-Bau Sh.p.k. me një arsyetim të përgjithësuar, pa arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare dhe të paargumentuar me asnjë fakt dhe provë konkrete, e gjithashtu pa mbështetje në dispozitat ligjore të zbatueshme në rastin konkret sipas LPP-së si ligj material dhe RRPP. Nga arsyetimi i vendimit të kundërshtuar shihet qartë se AK-ja duke ju shmangur detyrimeve dhe kompetencave ligjore i ka anashkaluar/injoruar të gjitha faktet dhe provat e paraqitura në secilin pretendim ankimor të kërkesës për rishqyrtim, të cilat lehëstisht kanë mundur të vërtetohen përmes dokumentacionit të dosjes/ofertës së dorëzuar nga GOE i shpërblyer me kontratë. Të gjitha faktet e paraqitura të cilat mbështeten dhe konfirmohen në prova konkrete (dokumentacionin e dosjes/ofertës së dorëzuar nga GOE i shpërblyer me kontratë) për argumentimin e pretendimeve të theksuara në kërkesë për rishqyrtim, vërtetohet se GOE të rekomanduar me kontratë nuk ka paraqitur tender të përgjegjshëm sepse nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat e specifikuara në DT.
Në pretendimin e parë, të dytë, të tretë, të katërt dhe të pestë, kemi paraqitur informacione dhe fakte bindëse të dokumentuara me dëshmi konkrete që vërtetojnë se GOE i shpërblyer me kontratë nuk i ka plotësuar kërkesat e domosdoshme të

specifikuara me numër 3, 4, 5 dhe 7 lidhur me Aneksin 1 nr. 6 të kapacitetit teknik dhe profesional lidhur me inxhinierin e gjeodezisë, inxhinierin e komunikacionit, për pajisjen *"kamion me mekanizëm komplet për fshirjen/larjen e rrugëve para vendosjes së sinjalizimit horizontal"* dhe pastaj planin për menaxhimin e trafikut, sepse dokumentacioni i paraqitur nuk është në përputhje siç specifikohet me kërkesat e parashtruara në DT dhe NJK (*përshkrimit dhe shpjegimeve të detajuara për secilin rast referoju në pretendimin ankimor përkatës*).

Në pretendimin e gjashtë kemi paraqitur informacione dhe fakte bindëse të dokumentuara me dëshmi konkrete që vërtetojnë se GOE i rekomanduar me kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën administrative të specifikuar në pikën 11.1 (a, b, c, d) të DT lidhur me marrëveshjen për themelimin e GOE, pasi që kjo marrëveshje si e tillë nuk i plotëson të gjitha kushtet e parashikuara ligjore sepse të njejtës i mungon (nuk është përfshirë) përshkrimi i specifikuar në germën (d) të pikës 11.1 të DT.

Prandaj, vet këto situata që janë evidentuar/konstatuar në kërkesën për rishqyrtim e që janë injoruar nga ana e AK-së gjatë procesit paraprak për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, e vërtetojnë se tenderi i dorëzuar nga GOE "TSR SH.P.K. & IDK KONSTRUKSION SH.P.K." nuk është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Në bazë të dispozitave ligjore të zbatueshme të legjislacionit të prokurimit, nenit 59.4 të LPP-së, nenit 40.6 të RRPP Nr. 001/2022, nenit 8.5 pika (ii) dhe (iii) të UPP Nr. 001/2023, përcaktohet se, tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. **Kriteret e përzgjedhjes nuk mund të kenë peshë të caktuara, ato janë kërkesa të vlerësimit kalon/nuk kalon, dhe në situatën si në rastin konkret kur kërkesat nuk janë përmbushur me të gjitha kërkesat e parashtruara në DT, tenderi i dorëzuar nga një tenderues të tillë do të refuzohen menjëherë.**

Kështu që, në kontekstin e fakteve dhe provave të paraqitura si më lart, vërtetohet se veprimet dhe aktet e AK-së bien ndesh me dispozitat relevante të zbatueshme në rastin konkret siç u theksuan më lartë, sepse AK-ja nuk i ka trajtuar operatorët ekonomik, (ofertat) në mënyrë të barabartë dhe jo - diskriminuese dhe në mënyrë transparente, për shkak se ekzaminimi dhe vlerësimi i tenderëve përfshirë dhe vendimin përfundimtar nuk është bërë në përputhje me kriteret e përcaktuara në DT dhe në përputhje me dispozitat ligjore të lartcekura, njëkohësisht nuk është marrë në konsideratë qëllimi dhe lënda e prokurimit në bazë të nenit 1 dhe 6 të LPP-së. Për faktin se, është shpërblyer për kontratë GOE që nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, kurse nga ana tjetër është diskualifikuar si tenderues i pasuksesshëm GOE ankues në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në DT dhe njëkohësisht ka plotësuar kriterin kryesor të dhënies së kontratës si tedneruesi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Në pretendimin e shtatë, kemi paraqitur informacione dhe fakte bindëse dhe konkrete që vërtetojnë se GOE i shpërblyer me kontratë ka ofertuar me çmime manipulative, nga njëra anë në disa pozicione me çmime jo-normalisht të ulëta (4.17, 4.18 dhe 4.20) në relacion me krahasimin e çmimeve reale të tregut, kurse nga ana tjetër në disa pozicione (2.1, 2.2, 2.5, 3.1, 3.2, 3.6, 3.10, 3.11 dhe 5.1)) ka ofertuar me çmime të fryera që janë shumë më të larta se ato të tregut. Çmimet e tilla jo-normalisht të ulëta dhe njëkohësisht të fryera që janë ofruar nga ana e GOE të shpërblyer me kontratë e dëmtojnë konkurencën e ndershme në relacion me OE që paraqesin oferta të bazuara në çmime reale të tregut, ndikojnë negativisht në cilësinë e punëve dhe shërbimeve që janë objekt i kontratës si dhe ndikojnë në shpenzimin e fondeve publike në kundërshtim me qëllimin e nenit 1 dh 6 të LPP. Andaj, në kuadër të këtyre çmimeve të identifikuara dhe konstatuara në kërkesën për rishqyrtim, ju paraqesim disa shembuj që ilustrojnë qartë pozicionet ku çmimet e paraqitura janë çmime jo-normalisht të ulëta që devijojnë ndjeshëm (disa herë) nga çmimet mesatare të tregut, strukturës së tij dhe nga kontratat paraprake.

Shembulli nr.1: Pozicioni Nr. 4.17: *Shërbimi dhe furnizimi për vendosjen, furnizimi dhe instalimin e pajisjeve radar vetedijesues - panel për kontrollimin e shpejtësisë Dimensionet e jashtme max. 750 x 640 x 80 mm e punuar nga alumini me trashësi 2 mm., sipas specifikimeve teknike te detyrueshme.* **Lidhur me këtë pozicion, për njësinë/sasinë 1 copë, GOE ka ofertuar me çmim përfshirë TVSH-në në shumën prej 320.00€.**

Këto pajisje nuk prodhohet në tregun e Kosovës mirëpo importohet nga tregjet europiane dhe janë prodhime të teknologjisë së fundit. Varësisht nga prodhuesi, çmimi mesatar i blerjes së një pajisje të tillë është nga 2,000.00€, ndërsa vetëm ekrani i cili shfaq mezashe sipas dimensioneve me siperfaqe prej 0.48m2 x 888€/m2 ka kosto prej 426.26 €, pa përfshirë shpenzimet shtesë të transportit, doganës, instalimit/montimit dhe shpenzimet tjera të lidhura. *Bashkangjitur gjeni linkun me specifikat teknike nga prodhuesi si dhe cmimin: 10 mm non-EN12966 compatible LDCOSP10.0CL price 888 Eur/sqm.* https://www.ledeca.com/en/ldcosp100cl-10mm-outdoor-commercial-compact-led-screen-u5

Pra, ky shembull ilustron qartë që çmimi i paraqitur nga GOE i shpërblyer me kontratë prej 320.00€ duke përfshirë edhe TVSH-në, është më shumë se 8 herë më i lirë se çmimi mesatar i tregut, gjë që tregon çmim manipulues/jo-normalisht të ulët dhe ngre dyshime për cilësinë, qëndrueshmërinë e shërbimit dhe realizimin e projektit. Kështu që, duke marrë parasysh shembullin me informacionet e mësipërme, rezulton se GOE të shpërblyer me kontratë ka ofertuar me çmime manipuluese dhe jo-normalisht të ulëta, respektivisht me kosto të pamunduar për t'u mbuluar koston e çmimit mesatar të blerjes dhe shpenzimeve tjera të lartcekura.

Shembulli nr.2: Pozicioni Nr. 4.18: *Shërbimi dhe furnizimi për vendosjen, furnizimin dhe instalimin e pajisjeve radar vetedijesues - panel për kontrollimin e shpejtësisë Dimensionet e jashtme min. 1500 x 1500 x 80 mm, e cila vendoset ne gjysmeportal, ne këtë pozicion të përfshihet edhe vendosja e gjysmeportalit komplet, sipas specifikimeve teknike te*

detyrueshme. **Lidhur me këtë pozicion, për njësinë/sasinë 1 copë, GOE ka ofertuar me çmim përfshirë TVSH-në në shumën prej 250.00€.**

Duke u bazuar në çmimet reale të tregut, çmimi mesatar dhe në përputhje me strukturën e tregut për furnizimin, shërbimin dhe punën (vendosjen dhe instalimin) deri në finalizim të vënies në funksion të një pajisje të tillë përfshirë edhe shpenzimet tjera të lidhura me këtë pozicion, ka një kosto prej **3,000.00€**

Po ashtu e njejta analogji dhe analizë vlen edhe për pozicionet tjera që janë identifikuar me çmime jo-normalisht të ulëta dhe për pozicionet me çmime të fryra që nuk përputhen me çmimet mesatare të tregut dhe strukturës së tij, duke përfshirë edhe kontratat paraprake të kësaj natyre.

Prandaj, pavarësisht se tenderi i GOE të shpërblyer me kontratë duhet të refuzohet si tender i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit, nisur nga informacionet e mësipërme që vërtetojnë se oferta e tij përmban çmime jo-normalisht të ulëta dhe nga ana tjetër pozicione me çmime të fryra (pajustifikuara), në dy rastet disa herë më pak apo ëm shumë se çmimet mesatare të tregut, e që kanë qenë përcaktuese për shpërblimin me kontratë për GOE "TSR SH.P.K. & IDK KONSTRUKSION SH.P.K.", duke ndikuar në eliminimin nga konkurenca të GOE ankues që ka ofertuar me çmime të tregut, duke u bazuar në legjislacionin e prokurimit publik, respektivisht duke pasur parasysh nenin 7 të LPP-së, AK në situatën konkrete është dashur që të veproj konform nenit 61 të LPP-së dhe nenit 41 e në veçanti me paragrafin 1 lidhur me paragrafin 4 dhe 8 të RRPP Nr. 001/2022. Për faktin se kjo është thelbësore nga njëra anë për të siguruar se të gjithë OE trajtohen në mënyrë të barabartë në përputhje me kërkesat qenësore të këtij ligji dhe nga ana tjetër për të parandaluar eliminimin apo cenimin e konkurencës së drejtë në relacion me OE që paraqesin oferta të bazuara në çmime reale të tregut, dhe rrjedhimisht për të parandaluar shpenzimin e fondeve publike në kundërshtim me qëllimin e nenit 1 dh 6 të LPP

Mirëpo siç e theksuam edhe më lart, nga ana e AK-së nuk janë marrë në konsideratë të gjitha këto pohime të OE ankues në relacion me faktet dhe provat konkrete të paraqitura veç e veç për secilin pretendim ankimor, e me të cilat vërtetohet qartë se GOE ka paraqitur tender të papërgjegjshëm në kundërshtim me kërkesat e DT dhe mes tjerash me dispozitat e lartcekura të LPP-së, RRPP Nr.001/2022 dhe UPP Nr. 001/2023. Prandaj AK-ja duke ju shmangur detyrimeve ligjore dhe duke i anashkaluar faktet vendimtare dhe rrethanave të rastit konkret ka paraqitur pasqyrim të gabuar të gjendjes faktike që nuk përkon me realitetin, rrjedhimisht që e ngatërron gjendjen e saktë faktike dhe juridike me qëllim që ipet përshtypja se asgjë e paligjshme nuk ka ndodhur. Dhe në këtë mënyrë të krijojë favore në dobi të GOE të shpërblyer me kontratë, respektivisht disfavor/diskriminim në dëm të GOE

ankues në kundërshtim me parimet baziek të LPP-së, konkretisht nenit 7 -Barazia në trajtim/diskriminim.

Prandaj, një arsyetim si ky, i përgjithësuar dhe i paprovuar me me asnjë fakt apo provë konkrete, në kontekstin ligjor sipas nenit 108/A paragrafi 12 të LPP-së dhe veçanërisht nenit 48 par.1 dhe 2 të LPP-së konsiderohet i papranueshëm, andaj vendosja mbi këtë bazë konsiderohet paragjykuese përderisa nuk vërtetohet me prova relevante. Sepse arsyet e përgjithësuara dhe paragjykuese në vendimin e AK-së nuk janë të mbështetura në baza ligjore sipas dispozitave ligjore të lartcekura, për faktin se vlerësimi dhe ekzaminimi, respektivisht rivlerësimi i vendimit të AK-së nuk është bërë duke respektuar kërkesat e aplikuara në DT si dhe faktet dhe provat relevante për vendosjen e drejtë dhe meritore të çështjes, por është udhëhequr në kundërshtim me parimet kryesore të vlerësimit dhe njëkohësisht në kundërshtim me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, parimin e ligjshmërisë dhe paanësisë në vendimarrje dhe qëllimit të prokurimit, duke e lënë në fuqi dhënien e kontratës për GOE që kanë dorëzuar tender të papërgjegjshëm. Në këtë kontekst, një arsyetim i tillë, i përgjithësuar dhe i paprovuar me asnjë fakt dhe provë konkrete, është i barabartë me mungesën e tij.

Më poshtë vazhdohet me përshkrimin e pretendimeve të njëjta si në kërkesën për rishqyrtim të paraqitur pranë AK-MMPHI.

Duke marrë parasysh të gjitha faktet, provat dhe rrethanat e paraqitura më lart, konsiderojmë se AK-ja, respektivisht komisioni i vlerësimit nuk i ka respektuar kriteret që vet i ka përcaktuar në DT dhe NJK, respektivisht nuk e ka respektuar dhe zbatuar në mënyrë të drejtë nenin 59 paragrafin 4 të LPP-së, ku shkruan se: *"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"*. Pastaj nuk e ka respektuar dhe zbatuar në mënyrë të drejtë nenin 40 të RRPP që shkruan se: **paragrafi 1 lidhur me paragrafin 13** *"Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve bëhet në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP, AK do t'i vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kritereve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.;* **paragrafi 2** *Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit;* **paragrafin 6** *Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:* ***a.*** *është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;* ***b.*** *është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;* ***c.*** *është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.* Dhe njëkohësisht nuk është respektuar dhe zbatuar në mënyrë të drejtë dhe ligjore, dispozita e nenit 60 e LPP-së lidhur me kriterin kryesor të dhënies së kontratës e cila në paragrafin 1 përcakton se:*Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët,* e me radhe dispozitat tjera relevante të LPP-së dhe RRPP. Kjo gjendje faktike konfirmohet dhe vërtetohet

në bazë të fakteve dhe provave përmes dokumenteve të dosjes së tenderit me të cilat ka ofertuar GOE në fjalë dhe që paraqiten si më poshtë:

Pretendimi i parë (1). GOE te rekomanduar për kontrate "TSR SH.P.K. & IDK SH.P.K.", nuk e ka plotësuar kriterin e kapacitetit profesional në përputhje me kërkesën nr. 3 e cila specifikon se OE duhet të ofrojnë një "*Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me tri vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit), ose Bahcelor i diplomuar i gjodezisë me pesë vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit)")"* e cila kërkohet të dëshmohet me dokumentacionin përkatës "*CV e inxhinierit, diploma e noterizuar (noterizimi të prezantohet nga vetë inxhinieri te noteri) kontrata e punës me ofertuesin (kopje e noterizuar, noterizimi të bëhet në prezencë të të dyja palëve), referenca për punët e mëparshme në lëminë e kërkuar lëshuara nga punëdhënësit.*

Lidhur me kërkesën e lartëcekur, në bazë të dokumentacionit tenderik me të cilat GOE në fjalë ka ofertuar në platformën e-prokurimi, bazuar në dëshmitë për ing. Ina Agaliu dhe ka paraqitur diplomën e saj e cila nuk është e noterizuar siç kërkohet, kështu që mungesa e noterizimit të kësaj kontrate nuk e plotëson kërkesën e AK-së. Prandaj bazuar në konstatimet dhe sqarimet e lartpërmendura GOE në fjalë nuk e ka plotësuar kërkesën në përputhje me përcaktimet e DT dhe NJK.

Pretendimi i dytë (2). GOE te rekomanduar për kontrate "TSR SH.P.K. & IDK SH.P.K.", nuk e ka plotësuar kriterin e kapacitetit profesional në përputhje me kërkesën nr. 4 e cila specifikon se OE duhet të ofrojnë "*Një (1) Inxhinier i diplomuar i komunikacionit me dy vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) ose Bachelor i diplomuar i komunikacionit me tri vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit)"* e cila kërkohet të dëshmohet me dokumentacionin përkatës "*CV e inxhinierit, diploma e noterizuar (noterizimi të prezantohet nga vetë inxhinieri te noteri) kontrata e punës me ofertuesin (kopje e noterizuar, noterizimi të bëhet në prezencë të të dyja palëve), referenca për punët e mëparshme në lëminë e kërkuar lëshuara nga punëdhënësit."*

Lidhur me kërkesën e lartëcekur, në bazë të dokumentacionit tenderik me të cilat GOE në fjalë ka ofertuar në platformën e-prokurimi, duke e paraqitur ing të komunikacionit Xhemil Halili, por nuk ka ofruar kontratë të punës për këtë aktivitet. Mirëpo e ka ofruar një kontratë tjetër (Kontratë pune për punë dhe detyra specifike) të cilën e ka lidhur me të njejtin në vitin 2011 për një projekt krejt tjetër, konkretisht për aktivitetin e prokurimit me titull "Sinjalizimi i rrugëve nacioanel, rajonale, rrugëve lidhëse dhe pajisjeve rrugore" me numër prokurimi 205-21-5391-5-11. Dhe përveç kësaj kjo kontratë nuk është e noterizuar siç specifikohet me kërkesën e parashtruar në DT. Prandaj bazuar në konstatimet dhe sqarimet e lartpërmendura GOE në fjalë nuk e ka plotësuar kërkesën nr. 4 në përputhje me përcaktimet e DT dhe NJK.

Pretendimi i tretë (3). GOE te rekomanduar për kontrate "TSR SH.P.K. & IDK SH.P.K.", nuk e ka plotësuar kriterin e kapacitetit profesional në përputhje me kërkesën nr. 4 e cila specifikon se OE duhet të ofrojnë një "*Një (1)Inxhinier i diplomuar i komunikacionit me dy vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) ose Bachelor i diplomuar i komunikacionit me tri vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit)"* e cila kërkohet të dëshmohet me dokumentacionin përkatës "*CV e inxhinierit, diploma e noterizuar (noterizimi të prezantohet nga vetë inxhinieri te noteri) kontrata e punës me*

ofertuesin (kopje e noterizuar, noterizimi të bëhet në prezencë të të dyja palëve), referenca për punët e mëparshme në lëminë e kërkuar lëshuara nga punëdhënësit."

Lidhur me kërkesën e lartëcekur, në bazë të dokumentacionit tenderik me të cilat GOE në fjalë ka ofertuar në platformën e-prokurimi, bazuar në dëshmitë për ing. Bekim Ahmeti ka paraqitur kontratën e tij të punës e cila nuk është e noterizuar, kështu që mungesa e noterizimit të kësaj kontrate nuk e plotëson kërkesën e AK-së. Gjitashtu ing në fjalë nuk e ka plotësuar kërkesën e AK-së edhe sa i përket kontratës së paraqitur për punë primare (të rregullt) për faktin se i njejti përveç kësaj kontrate ka marrëdhënie të rregullt pune me kontratë të rregullt - primare edhe Shkollën e mesme Teknike të Prishtinës, gjë që është në kundërshtim me legjislacionin e ATK-së, sepse nuk lejohen dy kontrata të punës primare. Prandaj bazuar në konstatimet dhe sqarimet e lartpërmendura GOE në fjalë nuk e ka plotësuar kërkesën në përputhje me përcaktimet e DT dhe NJK.

Pretendimi i katërt (4). GOE te rekomanduar për kontrate "TSR SH.P.K. & IDK SH.P.K.", nuk e ka plotësuar kriterin e kapacitetit teknik në përputhje me kërkesën nr. 7 Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 1, nr. 6 per llojin e mekanizimit "automjet *"kamion me mekanizëm komplet për fshirjen/larjen e rrugëve para vendosjes së sinjaliyimit horizontal"* e cila duhet të dëshmohet me dokumentacionin përkatës *"Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj). Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve....*

Kjo për faktin se lidhur me kërkesën e lartëcekur, konkretisht për per llojin e mekanizimit "automjet *"kamion me mekanizëm komplet për fshirjen/larjen e rrugëve para vendosjes së sinjaliyimit horizontal"* nuk ka paraqitur asnjë dëshmi/dokumentacion për posedimin e kësaj pajisje, respektivisht nuk e plotëson këtë kërkesë mininmale të specifikuar në DT dhe NJK.

Pretendimi i pestë (5). GOE te rekomanduar për kontrate "TSR SH.P.K. & IDK SH.P.K.", nuk e ka plotësuar kriterin e kapacitetit teknik në përputhje me kërkesën nr. 8 *"OE duhet te ofroj se bashku me oferte planin për menaxhimin e trafikut sa më të detajuar duke përfshira përshkrimin dhe skicat e rrugës e cila do te realizohet"* e cila është kërkuar të dëshmohet me dokumentacionin përkatës *"Origjinali i planit të menaxhimit të trafikut i nënshkruar nga inxhinieri i komunikacionit dhe vulosur nga kompania".*

Kjo për faktin se në bazë të dokumentacionit tenderik me të cilat GOE në fjalë ka ofertuar në platformën e-prokurimi, është gjetur se planit i paarqitur për menaxhimin e trafikut nuk është i nënshkruar nga inxhinieri i komunikacionit siç është kërkuar, andaj edhe nuk e plotëson kërkesën nr. 8 të specifikuar në DT dhe NJK.

Pretendimi i gjashtë (6). GOE te rekomanduar për kontrate "TSR SH.P.K. & IDK SH.P.K.", nuk e ka plotësuar kërkesën në pikën 11.1 lidhur me krijimin e grupit të operatorëve ekonomik lidhur me: **a)** ***një deklaratë e qartë*** *ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës;* **b)** ***një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët,*** *duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;* **c)** ***një deklaratë të nënshkruar*** *nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit;* dhe **d)** *Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të* ***jenë të përshtatshëm*** *dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.*

Kjo për faktin se në bazë të dokumentacionit tenderik me të cilat GOE në fjalë ka ofertuar në platformën e-prokurimi, është gjetur Marrëveshja për themelimin e GOE në fjalë nuk është në pajtueshmëri me kërkesën 11.1 të DT sepse i mungon përshkrimi i pikës d) e cila përcakton *se Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të* ***jenë të përshtatshëm*** *dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.* Kësisoji, në kontekst juridik nuk është në pajtueshmëri me kërkesat ligjore të paragrafit 4 të nenit 71 lidhur me nenin 65 të LPP-së.

Pretendimi i shtatë (7). Bazuar në analizimin e dokumentacionit tenderik, konkretisht ofertës së GOE të rekomanduar për kontratë sipas platformës e-prokurimi, kemi gjetur se i njejti ka ofertuar me çmime manipulative, nga njëra anë në disa pozicione me çmime jo-normalisht të ulëta nëse këto çmime krahasohen në relacion me çmimet reale të tregut që dëmtojnë konkurencën e ndershme në relacion me OE që paraqesin oferta të bazuara në çmime reale të tregut dhe që ndikojnë negativisht në cilësinë e punëve dhe shërbimeve që janë objekt i kontratës. Kurse nga ana tjetër në disa pozicione ka ofertuar me çmime të fryera që janë shumë më të larta se ato të tregut që e dëmtojnë konkurencën e ndershme dhe ndikojnë në shpenzimin e fondeve publike në kundërshtim me qëllimin e nenit 1 dh 6 të LPP-së.

Kjo gjendje faktike konfirmohet dhe vërtetohet në bazë të analizës faktike dhe gjithpërsfhirëse të ofertës me të cilat ka ofertuar GOE në fjalë dhe që paraqiten si më poshtë:

Pozicionet me çmime jo-normalisht të ulëta që janë edhe në kundërshtim me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të RRPP janë si më poshtë:

Pozicioni Nr. 4.17: *Shërbimi dhe furnizimi për vendosjen, furnizimi dhe instalimin e pajisjeve radar vetedijesues - panel për kontrollimin e shpejtësisë Dimensionet e jashtme max. 750 x 640 x 80 mm e punuar nga alumini me trashësi 2 mm., sipas specifikimeve teknike te detyrueshme.*

Lidhur me këtë pozicion, për njësinë/sasinë 1 copë, GOE ka ofertuar me çmim përfshirë TVSH-në në shumën prej 320.00€. Konsiderojmë se oferta e GOE me këtë çmim manipulues, përbën tender jo-normalisht të ulët në krahasim me çmimet reale të tregut, për faktin se bazuar në çmime reale të tregut dhe strukturës së tregut, çmimi mesatar i shërbimit dhe punës (përsfhirë shpenzimet tjera) për pozicionin në fjalë është nga 2,000.00€ e më lartë.

Pozicioni Nr. 4.18: *Shërbimi dhe furnizimi për vendosjen, furnizimin dhe instalimin e pajisjeve radar vetedijesues - panel për kontrollimin e shpejtësisë Dimensionet e jashtme min. 1500 x 1500 x 80 mm, e cila vendoset ne gjysmeportal, ne këtë pozicion të përfshihet edhe vendosja e gjysmeportalit komplet, sipas specifikimeve teknike te detyrueshme*

Lidhur me këtë pozicion, për njësinë/sasinë 1 copë, GOE ka ofertuar me çmim përfshirë TVSH-në në shumën prej 250.00€. Konsiderojmë se oferta e GOE me këtë çmim manipulues, përbën tender jo-normalisht të ulët në krahasim me çmimet reale të tregut, për faktin se bazuar në çmime reale të tregut dhe strukturës së tregut, çmimi mesatar i shërbimit dhe punës (përsfhirë shpenzimet tjera) për pozicionin në fjalë është nga 2,500.00€ e më lartë.

Pozicioni Nr. 4.20: *Shërbimi dhe furnizimi për vendosjen e Panel Solar per furnizim te shenjes sinjalizuese te kembesoreve me te dhenat si ne vijim: Fuqia 60 ë 12V, luxomat 12V, bateri 38Ah 12V, rregullator karikimi 10A 12V , me mundësi të lidhjes edhe në tension dhe me kabinet per magazinimin e pajisjeve me permasa 400x300x200mm.*

Lidhur me këtë pozicion, për njësinë/sasinë 1 copë, GOE ka ofertuar me çmim përfshirë TVSH-në në shumën prej 405.00€. Konsiderojmë se oferta e GOE me këtë çmim manipulues, përbën tender jo-normalisht të ulët në krahasim me çmimet reale të tregut, për faktin se bazuar në çmime reale të tregut dhe strukturës së tregut, çmimi mesatar i shërbimit dhe punës (përsfhirë shpenzimet tjera) për pozicionin në fjalë është nga 2,500.00€ e më lartë.

Pozicionet me çmime të fryera që janë shumë më të larta se ato të tregut janë si më poshtë:

Pozicioni Nr. 2.1: *Shërbimi për gërmimin e dheut i kategorisë së III-të, IV-të dhe V-të me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi 15km.*

Lidhur me këtë pozicion, për njësinë m³ dhe sasinë 1, GOE ka ofertuar me çmim përfshirë TVSH-në në shumën prej 42.00€. Konsiderojmë se oferta e GOE me këtë përbën çmim manipulues, respektivisht të fryrë jashtëzakonisht shumë në krahasim me çmimet reale të tregut, që e dëmtojnë konkurencën e ndershme dhe ndikojnë në shpenzimin e fondeve publike në mënyrë joefikase dhe joekonomike. Çmimi mesatar i shërbimit dhe punës (përsfhirë shpenzimet tjera) për pozicionin në fjalë varion nga 10.00€.

Pozicioni Nr. 2.2: *Shërbimi për punimin e mbushjes me material guror me bartje, shtrirje në shtresa dhe ngjeshje 40 MN/m2 me CBR>5%.Materiali sipas profilave terthor.*

Lidhur me këtë pozicion, për njësinë m³ dhe sasinë 1, GOE ka ofertuar me çmim përfshirë TVSH-në në shumën prej 41.00€. Konsiderojmë se oferta e GOE me këtë përbën çmim manipulues, respektivisht të fryrë jashtëzakonisht shumë në krahasim me çmimet reale të tregut, që e dëmtojnë konkurencën e ndershme dhe ndikojnë në shpenzimin e fondeve publike në mënyrë joefikase dhe joekonomike. Çmimi mesatar i shërbimit dhe punës (përfshirë shpenzimet tjera) për pozicionin në fjalë varion meatarisht nga 10.00€.

Pozicioni Nr. 2.5: *Shërbimi për punimi i bankinave me tampon duke llogaritur furnizimin dhe transportin.*

Lidhur me këtë pozicion, për njësinë m² dhe sasinë 1, GOE ka ofertuar me çmim përfshirë TVSH-në në shumën prej 21.00€. Konsiderojmë se oferta e GOE me këtë përbën çmim manipulues, respektivisht të fryrë jashtëzakonisht shumë në krahasim me çmimet reale të tregut, që e dëmtojnë konkurencën e ndershme dhe ndikojnë në shpenzimin e fondeve publike në mënyrë joefikase dhe joekonomike. Çmimi mesatar i shërbimit dhe punës (përfshirë shpenzimet tjera) për pozicionin në fjalë varion mesatarisht nga 5.00€.

Pozicioni Nr. 3.1: *Shërbimi, punimi dhe shtrirja e shtresës se materiali mbushes zhavori (0-150) mm me trashësi t=100cm apo ma shum sipas nevoje me ngjeshje 40 MN/m² me cilinder me vibracion (Ky material përdoret ne vende jo stabile te trases)-Sipas nevojës*

Lidhur me këtë pozicion, për njësinë m³ dhe sasinë 1, GOE ka ofertuar me çmim përfshirë TVSH-në në shumën prej 40.00€. Konsiderojmë se oferta e GOE me këtë përbën çmim manipulues, respektivisht të fryrë jashtëzakonisht shumë në krahasim me çmimet reale të tregut, që e dëmtojnë konkurencën e ndershme dhe ndikojnë në shpenzimin e fondeve publike në mënyrë joefikase dhe joekonomike. Çmimi mesatar i shërbimit dhe punës (përfshirë shpenzimet tjera) për pozicionin në fjalë varion mesatarisht nga 15.00€.

Pozicioni Nr. 3.2: *Shërbimi, dhe rrafshimi i nënbazës me ngjeshje (40MN/m²) me cilindër me vibracion i përshtatshëm për zgjerimet ne rrugët e përcaktuara.*

Lidhur me këtë pozicion, për njësinë m³ dhe sasinë 1, GOE ka ofertuar me çmim përfshirë TVSH-në në shumën prej 30.00€. Konsiderojmë se oferta e GOE me këtë përbën çmim manipulues, respektivisht të fryrë jashtëzakonisht shumë në krahasim me çmimet reale të tregut, që e dëmtojnë konkurencën e ndershme dhe ndikojnë në shpenzimin e fondeve publike në mënyrë joefikase dhe joekonomike. Çmimi mesatar i shërbimit dhe punës (përfshirë shpenzimet tjera) për pozicionin në fjalë varion mesatarisht nga 1.00€.

Pozicioni Nr. 3.6: *Shërbimi dhe punimi i tamponit (100MN/m²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm në rrugë dhe trotuar me trashësi sipas detaleve dhe profilave terthor.*

